

# Një hartëzim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit



## Historiku

Qëllimi i këtij raporti të shkurtër është të ofrojë informacione mbi rezultatet e arritura gjatë implementimit të "Projektit për Rritjen e Eksportit" nga Agjencia për Zhvillim Rajonal (AZHR-Q) dhe mbështetur nga projekti "Krijimi i Punësimit përmes Promovimit të Eksportit" të Agjencisë Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH. Raporti konsiston një përmbledhje të situatës aktuale të sektorëve të përpunimit dhe prodhimit të drurit dhe metaleve, një përmbledhje të ndihmës teknike të ofruar përfituesve të përzgjedhur nga të ashtuquajturit "Mentorë të Eksportit" të Agjencisë për Zhvillim Rajonal-Qendër, dhe një listë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me seli në pesë rajone të Kosovës.

### Sfidat për sektorët e përpunimit të drurit dhe metaleve

Sipas Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), sektori i përpunimit të drurit në Kosovë konsiderohet të jetë njëri ndër sektorët më strategjikë me


Burimi: AZHR-Q (2020) Raporti i shkurtër final: Projekti për Rritjen e Eksportit për prodhuesit e drurit dhe metaleve.

Grafiku bazohet në përgjigjet individuale të 51 të anketuarve nga sektori privat dhe thekson sa vijon:

- Një skemë e granteve për azhurnimin e makinerive ose për investime është dukshëm më e dëshirueshme sesa kërkesat e tjera. Pothuajse të gjithë të anketuarit mbështetën këtë masë

- Asistenca teknike, programet e mentorimit ose këshillimit janë më së paku të dëshiruara. Të gjitha segmentet tjera: trajnimi për transformim digjital, lehtësimi në procesin e certifikimit ISO, pjesëmarrja në panaire tregtare ndërkombëtare dhe trajnimi i stafit profesional (76 përqind deri 90 përqind e të anketuarve mbështesin këtë masë) vlerësohen relativisht të lartë, duke sugjeruar që këta përfitues janë të hapur për të azhurnuar aspektet administrative dhe operative të biznesit të tyre, dukshmërinë e kompanive përmes marketingut, si dhe zgjerimin e tregut.

Grafiku 1: Kërkesat kryesore nga përfituesit



me potencial të madh për zhvillim. Mirëpo, pengesat më të mëdha për eksport janë efikasiteti i dobët i doganave në vendet tranzite dhe vendet importuese, kostot e larta të garancive bankare dhe varësia nga marrëdhëniet politike me vendet importuese<sup>1</sup>.

Sektori i përpunimit të metaleve në Kosovë, së bashku me minierat dhe sektorin e minierave, ka pjesën më të madhe në BPV. Sidoqoftë, përkundër investimeve në teknologjinë e prodhimit dhe pajisje, kjo industri është akoma nën konsolidim dhe ende nuk është plotësisht në gjendje të bëhet konkurruese ose të eksportoje në tregjet rajonale ose të BE-së<sup>2</sup>.

Për rritjen e mëtejme dhe zhvillimin e biznesit të tyre, kompanitë për përpunimin e metaleve dhe drurit përmendën nevojat e mëposhtme si më të rëndësishmet: skemat e granteve për të investuar kryesisht në azhurnimin e makinerive, lehtësimin në procesin e certifikimit ISO, lehtësimin për pjesëmarrje në panairet tregtare ndërkombëtare, trajnime në informacion digjital, asistencë teknike dhe trajnim të stafit. Këto mund të shtojnë vlerë në përpunimin primar të drurit dhe produkteve metalike dhe të gjenerojnë të hyra më të larta.

## Përmbledhje e situatës aktuale të sektorëve për përpunimin dhe prodhimin e drurit dhe metaleve

Konsumi i orendive shtëpiake varet nga niveli i të ardhurave të disponueshme të një popullsie. Aktualisht, kushtet ekonomike dhe standardi i jetesës në Kosovë do të thotë që njerëzit janë duke ulur shpenzimet e amvisërisë dhe duke u përqendruar në kursimin e parave. Sidoqoftë, në rajone të caktuara, një rritje në punësim dhe rritje të pagave ka rezultuar në një treg më të mirë ekonomik (AZHR-Q 2020: intervistat me kompani). Ndërsa nivelet e papunësisë po ulen, normat e ulëta të kostove të ndërtimit dhe zhvlerësimi i shtëpive tregojnë një treg të paqëndrueshëm ekonomik për orenditë shtëpiake (AZHR-Q 2020: intervista me kompani). Shpenzimet në kryeqytetin Prishtinë dhe rrethinë kanë tendencë të jenë më të larta për shkak të një tregu më të madh dhe fuqisë më të madhe blerëse. Kjo e bën Prishtinën dhe zonat përreth saj një vend të mirë për shitësit ose produktet prej druri dhe metali.

<sup>1</sup> Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Profili i sektorit të industrisë së përpunimit të drurit. <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/5C393E89-F90A-43D6-9F4F-46BCF7B883F4.pdf>

<sup>2</sup> Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Profili i sektorit të industrisë së përpunimit të metaleve <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/C36E2ABF-201E-4292-8497-62307E66EED3.pdf>

## Trendet

### Blerja në nivel lokal

Një trend tjetër në rritje në treg është blerja në nivel lokal. Pjesa më e madhe e kësaj shihet në industrinë ushqimore. Mirëpo, blerja e mallrave lokale, të tilla si mobiliet dhe orënditë, por edhe në industrinë e ndërtimit, kohëve të fundit ka shënuar një trend në rritje.

### Analizat e Produkteve Online

Për konsumatorët që janë vazhdimisht të lidhur, kërkimi për blerje online është thjesht një mundësi tjetër, sesa një medium krejtësisht i veçantë dhe i dalluar. Informacioni dhe ndërgjegjësimi lidhur me produktet online është një realitet gjithnjë e më i pranishëm te kompanitë që përpiqen të ulin ndikimin e ndërmjetësit dhe kostot e tjera.

### Përshtatja për ruajtjen e mjedisit

Ka një rritje në përdorimin e burimeve dhe metodave për prodhimin e mobilieve që janë të përshtatshme për mjedisin. Një aspekt tjetër i përshtatjes për ruajtjen e mjedisit është përdorimi i mobilieve të vjetra dhe të ricikluara si dhe përtëritja e tyre. Disa prodhues vendorë e marrin këtë parasysh kur mendojnë për opsione të tjera lidhur me dizajnin dhe shitjet e mobilieve

### Shtimi i funksionalitetit

Konsumatorët po kërkojnë mënyra inovative për të kursyer hapësirë dhe kohë duke inkorporuar gjësende tjera në mobiliet e tyre. Kjo prirje ka potencial të shërbejë si një mundësi për shumëllojshmëri dhe të tërheqë një grup më të larmishëm të blerësve.

### Strategjia biznesore

Sipas hulumtimit të tregut të kryer nga projekti, sa më të përparuara teknikisht janë bizneset aq më të zhvilluara janë strategjitë e tyre biznesore. Këto përfshijnë zgjerimin e hapësirave operacionale dhe investimet në makineri dhe teknologji të tjera.

## Një përmbledhje e ndihmës teknike të ofruar për përfituesit e përzgjedhur nga Mentorët e Eksportit

Gjatë fazës së projektit "Identifikimi i çështjeve rregullatore dhe të certifikimit", mentorët e eksportit ishin përgjegjës për ofrimin e trajnimeve të drejtpërdrejta për ndërmarrjet e identifikuara dhe materialeve tjera lidhur me certifikimet, dokumentacionin, metodologjitë e menaxhimit, udhëzimet për tarifën, udhëzimet për ambalazhim, licencat dhe markat tregtare, proceset e eksportit, procedurat doganore, etj. Në mënyrë të veçantë, kompanitë ishin këshilluar për metodologji të hollësishme të përdorura ndërkombëtarisht, për menaxhimin e dokumenteve dhe certifikimet e mëtejme për menaxhim, certifikime teknike dhe certifikimet për produktet. Lidhur me sistemin për menaxhimin e dokumenteve, mentorët e eksportit ishin përgjegjës për një shpjegim të shkurtër të ISO 9001, i cili përcaktohet si 'standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë. Kompanitë e përdorin këtë standard për të demonstruar aftësinë për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorit dhe kërkesat rregullative. Më poshtë janë paraqitur disa nga standardet ISO të përdorura ndërkombëtarisht që iu janë shpjeguar kompanive nga ekspertët e projektit:

- ISO 14001 është një standard i dakorduar ndërkombëtarisht që përcakton kërkesat për një sistem për menaxhimin e mjedisit. Ai iu ndihmon organizatave të përmirësojnë performancën e tyre mjedisore përmes përdorimit efikas të burimeve dhe zvogëlimit të mbeturinave, duke fituar më pas një përparësi konkurruese dhe besimin e palëve të interesuara.

-ISO 45001 përqendrohet në identifikimin dhe kontrollimin e mundësive për rrezik sesa vet rreziqeve, siç kërkohet aktualisht në OHSAS 18001.

- ISO 45001 u kërkon organizatave të shqyrtojnë sesi furnizuesit dhe kontraktuesit po menaxhojnë rreziqet e tyre.

- Në ISO 45001 disa koncepte themelore janë ndryshuar, p.sh. rreziku, fuqia punëtore dhe rregulloret për vendet e punës. Në mesin e disa kompanive të identifikuara të cilat janë në industrinë e përpunimit të metaleve u shpjegua edhe certifikimi CE, i cili është një markë certifikimi që tregon pajtueshmërinë me standardet për shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit për produktet e shitura brenda Zonës Ekonomike Evropiane.

- Udhëzimi ISO 9001: 2015 për procedurat e dokumentimit të informacioneve, si dhe përfitimet, pengesat, zgjidhjet e disponueshme në treg për mjetet online dhe aplikacione të tjera u përpunuan gjatë seancave të mentorimit.

- U shpjeguan certifikimet me Sistemet Ndërkombëtare të Menaxhimit bazuar në standardet ISO, posaçërisht ISO 9001: 2015 (sistemi i menaxhimit të cilësisë), ISO 14001: 2014 (sistemi i menaxhimit të mjedisit), OHSAS 18001: 2007 / ISO 45001: 2018 (shëndeti dhe siguria në punë) materiale tjera informuese/edukative iu ofruan çdo ndërmarrjeje.

## Shembuj të ndërmarrjeve në pesë rajonet e Kosovës

Analiza e situatës aktuale	Rajoni Qendër
<b>GreatWood</b> është e specializuar në dizajnet për mikpritje, kuzhinë dhe shitje me pakicë. GreatWood është një kompani mirë e themeluar në industrinë e përpunimit të drurit në Kosovë. Ajo është e njohur për krijimin e strukturave të drurit të papërpunuar, ku thurjet origjinale ruhen dhe prezantohen si përparësi kryesore e produkteve të tyre.	
<b>PaintWorks</b> është një kompani e cila përqendrohet në përpunimin e drurit të bazuar në projekte. Ajo punon me dru të fortë, kompensatë dhe rimeso me një fushë të gjerë prodhimi. Paint Works ka një klientelë shumë specifike, kryesisht klientelë të nivelit të lartë. Kompania është e përqendruar në përdorimin e cilësisë më të lartë të produkteve të drurit dhe teknologjisë së përpunimit.	
Kompania <b>Art Aluminium</b> ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2010, në zonën industriale të Prishtinës. Objekti i saj ka një sipërfaqe prej 15000 m <sup>2</sup> . Plani i saj është të zgjerohet në tregun evropian dhe të certifikohet në kërkesat dhe standardet evropiane	
<b>Art Design</b> u themelua në vitin 1994. Kompania është krijuar si një biznes familjar dhe vazhdon si e tillë. Art Design është përqendruar në prodhimin në nivel fabrike të mobilieve nga tallashi i ngjeshur dhe struktura të përziera druri. Kohët e fundit ajo ka investuar në një linjë të re prodhimi e cila përmirëson procesin e prodhimit.	
<b>Orendi Shpk</b> është përqendruar në prodhimin e veçantë të mobilieve nga druri artificial dhe natyral. Fokusi ishte investimi në ndërtimin e brendit dhe identitetin e korporatës. Ajo është certifikuar në ISO 9001 dhe certifikime të tjera përkatëse.	
<b>Dekorit</b> është kompani për përpunimin e drurit e bazuar në projekt e cila punon me dru të fortë, kompensatë dhe rimeso në një fushë të gjerë të prodhimit. Aktualisht ajo është në fazën finale të përfundimit të një Qendre Trajnimi. Si kompani ajo ka potencial të madh për të rritur linjën e saj të prodhimit dhe nivelet e eksportit.	
<b>Limani Mobileri</b> Aktiviteti kryesor është prodhimi i mobilieve të zyrës me bazë druri dhe tallashi të ngjeshur, kuzhina me porosi, dollapë, dhoma gjumi dhe produkte të ngjashme prej druri.	

Analiza e situatës aktuale	Rajoni Veri
<b>Era</b> është një kompani e vogël për përpunimin e drurit me seli në rajonin verior të Kosovës dhe ka potencial për të furnizuar të 4 komunat të cilat janë të populluara nga komuniteti etnik serb. Duke marrë parasysh pjesën aktuale të tregut brenda popullatës serbe në komunat veriore, ajo ka potencial të konsiderueshëm për të depërtuar në Serbinë jugore dhe ndoshta vendet e tjera të rajonit me produkte të përpunuara nga druri.	
<b>Veli</b> është një kompani e përpunimit të drurit me madhësi të mesme me potencial të konsiderueshëm për tu zgjeruar dhe eksportuar më tej. Kompania operon në dy lokacione dhe ka potencial të konsiderueshëm për të rritur pjesën e saj të tregut dhe për të filluar eksportimin e mobilieve në vendet e BE-së.	
<b>Kontaktori</b> është një kompani e vogël për përpunimin e metaleve, e specializuar në prodhimin e kabinave elektrike. Menaxhmenti i kompanisë shqyrton mundësinë e implementimit dhe certifikimit me ISO 9001 dhe blerjen e makinerive të reja si investime vendimtare për të siguruar rritje të qëndrueshme të biznesit.	
<b>Araf</b> është kompani e vogël për përpunimin e metaleve, e specializuar në prodhimin e konstruksioneve metalike.	
<b>Mobilie</b> është një kompani e vogël për përpunimin e drurit me potencial për të zgjeruar aftësitë e saj të prodhimit dhe pjesën aktuale të tregut në tregjet lokale dhe rajonale. Produkti kryesor i kompanisë janë paletat prej druri.	
<b>Europa Company</b> është një kompani me madhësi të mesme e specializuar në prodhimin e peletit nga druri. Aktualisht, kompania është e pajisur me makineritë e nevojshme për deponimin, përpunimin dhe paketimin e peletit.	

### Analiza e situatës aktuale Rajoni Lindje

<p><b>Promobi Sh.p.k.</b> është një kompani e përpunimit të drurit, e përqendruar kryesisht në prodhimin e mobilieve prej druri, të tilla si kuzhina, karrige, tavolina ngrënieje, mobilie për dhoma gjumi, mobilie të brendshme për hotele, motele, restorante, kafene, etj.</p>
<p><b>Metali i Ri Sh.p.k.</b> është një kompani e përqendruar në prodhimin, përpunimin dhe përfundimin e artikujve të mobilieve për shkolla dhe universitete (karrige dhe tavolina), mobilie për biznese të tjera të tilla si restorante, kafene, mobilie shtëpiake etj., kryesisht nga materiale metalike, dhe nganjëherë edhe me panele druri. Kompania ka potencial për rritje jo vetëm brenda Kosovës por edhe për eksport. Sidoqoftë, kompania duhet të marrë masat e nevojshme për të përmirësuar organizimin, administratën e përgjithshme dhe rritjen e produktivitetit të prodhimit.</p>
<p><b>Xheti Dekor Shpk</b> operon në produktet për përpunimin e metaleve, duke prodhuar dhe përpunuar një gamë të gjerë produktesh si: dyer metalike për garazhe, çadra dielli, gardhe për shkallë, gardhe oborri, profile dhe dekorime hekuri, dekorime të ndryshme hekuri, profile të tjera metalike për përdorime të ndryshme.</p>
<p><b>Rinia Sh.p.k.</b> është e specializuar në prodhimin e mobilieve prej druri të një game të gjerë produktesh, të tilla si kuzhina, tryeza të ngrënies, divane, dhoma të ndenjes, dhoma të gjumit, etj. Ka kapacitete për tu zgjeruar më tej.</p>
<p><b>Exim Metal</b> specializohet në projektimin, prodhimin dhe instalimin e të gjitha llojeve të strukturave prej çeliku në të gjithë Kosovën. Kompania operon për më tepër se 15 vite dhe ofron zgjidhje inovative nga çeliku.</p>

### Analiza e situatës aktuale Rajoni Jug

<p><b>Sylka Sh.p.k.</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e rrjetave metalike, telave plastikë, rrjetave të zeza valore dhe rrjetave të zinkut të valëzuar me rrjet të integruar të panelit. Kompania ka eksportuar në Shqipëri dhe Bullgari dhe vazhdimisht po kërkon mënyra të reja për të depërtuar në tregun Evropian.</p>
<p><b>Sinjalizimi</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e konstruksioneve metalike, shenjave dhe artikujve metalikë.</p>
<p><b>Kompania EKOPAK</b> është e specializuar në prodhimin e kontejnerëve dhe paketimeve prej druri.</p>
<p><b>N.t.p. Frigo Toni</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e sistemeve të ventilimit dhe frigoriferëve.</p>
<p><b>PRIMO HOME Sh.p.k.</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e mobilieve, dhomave, kuzhinave dhe pajisjeve të zyrës.</p>
<p><b>N.t.sh Muzbeg-F</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e furnizimeve të zyrës dhe mobilieve.</p>
<p><b>PRIMO HOME Sh.p.k.</b> Kompania është e specializuar në përpunim metalik dhe prodhimin e kuzhinave industriale.</p>

### Analiza e situatës aktuale Rajoni Perëndim

<p><b>AB- Coating Sh.p.k.</b> Kompania prodhon gardhe nga teli i petëzuar, dyer dhe konstruksione metali, gardhe ballkoni, etj. Kompania ka sisteme të qëndrueshme të cilësisë, duke u siguruar që produktet e saj të prodhohen me cilësinë e nevojshme, dhe duke përdorur lëndë të parë me makineri efektive për të shmangur çdo humbje materiale.</p>
<p><b>Naser Kajtazaj B.I. - "Eurometal-N"</b> prodhon produkte për përpunimin e metaleve, të tilla si: dyer metalike, gardhe për shkallë, gardhe të oborrit, profile dhe dekorime hekuri, dekorime të ndryshme hekuri, dhe profile të tjera metalike për përdorime të ndryshme</p>
<p><b>Hoti Group</b> është kompani me madhësi mesatare për përpunimin e metaleve, e specializuar në prodhimin e konstruksioneve metalike. Ajo ka potencial për të zgjeruar më tej aftësitë e saj të prodhimit dhe për të filluar aktivitetet e eksportit.</p>
<p><b>Ar-En</b> është një kompani e vogël për përpunimin e drurit me potencial të konsiderueshëm për tu rritur dhe eksportuar. Kjo kompani është e specializuar në dizajnimin dhe prodhimin e kuzhinave prej druri, dizajnimin dhe prodhimin e mobilieve dhe interierit të kafeneve.</p>
<p><b>Ideal Vokshi Sh.p.k.</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e konstruksionit metalik.</p>
<p><b>Final Sh.p.k.</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e mobilieve dhe përpunimin e produkteve të drurit.</p>
<p><b>N.p.t. Metaliku Xhaxhi</b> Kompania është e specializuar në prodhimin e kornizave të dyerve dhe dritareve nga metali.</p>



Publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara në Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit

Zyra e GIZ Kosovë  
Rruga Gazmend Zajmi 80

10 000 Prishtinë, Kosovë.  
Tel. +381 (0) 38 233 002 507  
Fax +381 (0) 38 233 002 530  
giz-kosovo-buero@giz.de

prej

Mars 2021

Dizajni

MLE Group sh.p.k., Prishtinë

Dizajni i kopertinës

Engjëll Sokoli

Teksti

Fatos Hoxha

GIZ është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij publikimi.

Në emër të

Ministrisë Federale për Bashkëpunim  
Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)